



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 147, datë 31.08.2022

**PËR
MIRATIMIN E KUSHTEVE STANDARDE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË
JETËS SË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, QË DËRGOHEN NË MISIONE USHTARAKE DHE STËRVITJE
JASHTË VENDIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 26.05.2022 “Për sigurimin e jetës së personelit të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e kushteve standarde të kontratës së sigurimit të jetës së personelit të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

KUSHTET STANDARDE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË JETËS TË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË DËRGOHEN NË MISIONE USHTARAKE DHE STËRVITJE JASHTË VENDIT

Neni 1

Përkufizime

1. **“Kushtet standarde të kontratës së sigurimit”** janë pjesë e kushteve të kontratës së sigurimit, të cilat shërbejnë si kushte minimale të detyrueshme për tu zbatuar nga shoqëritë e sigurimit.
2. **“I Siguruari”** do të quhet personeli në listën e “Grup i siguruar” ose në ndryshime të mëvonshme të saj.
3. **“Grup i Siguar”** janë personi/personat e forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohet/n në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit.
4. **“Siguruesi”** është shoqëria e sigurimit jetë/jojetë e licencuar nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat në të cilën përfshihet ky produkt.
5. **“Kontraktuesi”** është punëdhënësi i përcaktuar si Kontraktues në Formularin e Policës.
6. **“Përfituesi”** do të quhet anëtari i grupit të siguruar ose trashëgimtarët ligjorë të tij, sipas përcaktimeve të Kodit Civil.
6. **“Polica e sigurimit”** është dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, formulari dhe çdo shtojcë ose ndryshim i mëvonshëm i lëshuar nga Siguruesi.
7. **“Certifikatë e Sigurimit”** është dëshmia e sigurimit që “Siguruesi” i lëshon të “Siguarit”.
8. **“Prim i sigurimit”** është shuma e mjeteve monetare që kontraktuesi i paguan Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate.
9. **“Limiti i përgjegjësisë”** është shuma e sigurimit e përcaktuar në policën e sigurimit e cila nuk mund të jetë më e ulët se:
 - a) 10,000,000 (dhjetë milion) lekë për rastet e humbjes së jetës për shkak të detyrës a zhdukjes së personit;
 - b) 5,000,000 (pesë milion) lekë për rastet e dëmtimit të rëndë fizik;
 - c) 5,000,000 (pesë milion) lekë për rastet e humbjes së jetës, si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të detyrës;
 - d) 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për rastet e dëmtimit të lehtë fizik.
10. **“Përfitim”** është shuma përkatëse e sigurimit ose pjesë e saj siç përcaktohet në policën e sigurimit dhe tabelën e përfitimeve, e pagueshme nga siguruesi në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj police, për çdo ngjarje ose dëmtim që mbulohet nga kjo policë.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është siguri i jetës së personelit të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit.

Neni 3

Mbulimi në sigurim

Kontrata e sigurimit të personelit të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake dhe stërvitje jashtë vendit, mbulon ngjarjet si më poshtë vijon:

- a) Humbjen e jetës për shkak të detyrës apo si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të saj;
- b) Zhdukjes;
- c) Paaftësi e përhershme të plotë apo të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe/ose stërvitjes jashtë vendit;
- ç) Paaftësi e përkohshme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë kohëzgjatjes së misionit ushtarak dhe/ose stërvitjes jashtë vendit;
- d) Shërbimet mjekësore në spitalet publike ose private brenda dhe/apo jashtë shtetit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike.

Neni 4

E drejta për të qenë i siguruar

Të siguruar janë të gjithë personat, anëtarë të “Grup i Siguruar”.

Neni 5

Hyrja në fuqi e kontratës së sigurimit

Kontrata e Sigurimit hyn në fuqi në orën 24:00 të ditës së përcaktuar në kontratën e sigurimit.

Neni 6

Primi i sigurimit

1. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në formularin e policës së sigurimit.
2. Primi i sigurimit paguhet sipas përcaktimeve në formularin e policës së sigurimit.

Neni 7

Limiti i përgjegjësisë

Limiti i përgjegjësisë për çdo person të siguruar, e përcaktuar në formularin e policës së sigurimit, nuk mund të jetë më e ulët se:

- a) 10,000,000 (dhjetë milion) lekë për rastet e humbjes së jetës për shkak të detyrës a zhdukjes së personit;

- b) 5,000,000 (pesë milion) lekë për rastet e dëmtimit të rëndë fizik;
- c) 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për rastet e dëmtimit të lehtë fizik;
- ç) 5,000,000 (pesë milion) lekë për rastet e humbjes së jetës, si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 8

Tabela e koeficientëve të përfitimit

1. Tabela e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, përcakton rastet për përfitimin e pagueshëm në përqindje ndaj shumës së sigurimit si më poshtë:

A	Humbja e jetës	100%
B	Paaftësi e Përherhshme¹	
1	Paaftësi e Plotë e Përherhshme	100%
2	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e përherhshme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3	Humbje e plotë e përherhshme e shikimit në të dy sytë	100%
4	Humbje e plotë e përherhshme e shikimit në një sy	50%
5	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	deri në 100%
6	Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
7	Humbje e plotë e përherhshme e dëgjimit	
	a) në të dy veshët	60%
	b) në një vesh	15%
8	Humbje e plotë e të folurës	30%
9	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e përherhshme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	deri në 42%
	b) të majtë	deri në 40%
10	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e përherhshme e përdorimit të gishtërinjve të dorës	
	a) gishti i madh i dorës së djathtë	deri në 20%
	b) gishti i madh i dorës së majtë	deri në 15%
	c) gishti tregues, apo i mesit i dorës së djathtë	deri në 12%
	d) gishti tregues, apo i mesit i dorës së majtë	deri në 10%
	e) gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së djathtë	deri në 4%
	f) gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së majtë	deri në 3%
11	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e falangës së gishtit të dorës	deri në 1/3 e gishtit përkatës

¹ Në rastet kur i Siguruari është mëngjërash, përqindjet e përfitimeve të tabelës më sipër do të këmbehen duke pasur parasysh se përqindja më e lartë e përfitimit do të zbatohet për dorën e majtë dhe pjesët e saj.

12	Humbje e pjesshme ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës		
	a) të gjithë gishtërinjtë e një këmbe	deri në 20%	
	b) gishti i madh i këmbës	deri në 10%	
	c) një gisht i këmbës (II-V)	deri në 2.5%	
13	Imobilitet i plotë i përdorimit të një këmbe në nivelin e nyjes së këmbës	30%	
14	Imobilitet i plotë i kofshës në nivelin e artikulacionit koksofemoral	40%	
15	Imobilitet i plotë i artikulacionit të kycit	30%	
16	Dëmtimi i plotë një veshke	40%	
17	Dëmtimi i plotë i shpretkës	20%	
18	Djegje të shkallës së tretë		
	Zona	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
	- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	20%
		e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	35%
		e barabartë ose më e madhe se 8%	75%
	- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	20%
		e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	35%
		e barabartë ose më e madhe se 20%	75%

2. Përveç sa më sipër për dëmtimet shëndetësore që nuk parashikohen në këtë tabelë shkalla e dëmtimit përcaktohet nga mjeku specialist.

Shuma agregate e përfitimit nuk e kalon limitin e përgjegjesisë sipas përcaktimeve të nenit 7.

C: Paaftësia e përkohshme

1 Paaftësia e përkohshme e plotë	2,500 lekë/ditë.
2 Paaftësia e përkohshme e pjesshme	1,500 lekë/ditë.

Për dëmtimet e lehta fizike, më paaftësi të përkohshme deri në 9 ditë, përfitimi ditor nuk mund të jetë më i ulët se 1,500 lekë.

Shuma agregate e përfitimit nuk e kalon limitin e përgjegjesisë sipas përcaktimeve të nenit 7.

Neni 9 **Përfitimet**

Përfitimet e përcaktuara në këtë kontratë, nuk do të zbatohen për rastet që nuk lidhen me misionin ushtarak dhe/ose stërvitjen për të cilën janë dërguar jashtë vendit.

Neni 10

Njoftimet dhe deklarimet

Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Siguruesit, listën me identitetin e të gjithë personave të "Grup i siguruar", moshën, si dhe çdo informacion tjetër me kërkesë të siguruesit, i cili mund të jetë i nevojshëm për vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e nivelit të primit të sigurimit.

Neni 11

Përfundimi i mbulimit në sigurim

Mbulimi në sigurim përfundon me ndodhjen e më të hershmes prej ngjarjeve të mëposhtme:

1. Kur ka përfunduar ekzekutimi i tabelës të përfitimeve të përcaktuara në Policë;
2. Data në të cilën i siguruari përfundon misionin ushtarak dhe/ose stërvitjen jashtë vendit;
3. Përfundimi i periudhës së policës së sigurimit.

Neni 12

Përfshirja dhe largimi

1. Kjo Policë do të mbulojë automatikisht në sigurim të gjithë personat, anëtarë të "Grup i siguruar".
2. Kontraktuesi gëzon të drejtën e zëvendësimit të një personi të larguar me një të ri pa paguar prim shtesë, me kushtin e njoftimit brenda 10 ditëve nga data e zëvendësimit.

Neni 13

Procedura e dëmshpërblimit

1. Njoftimi i ngjarjes së sigurimit.

Çdo ngjarje ose dëmtim që mund të çojë në një kërkesë për pagesë/përfitim sipas kësaj kontrate duhet t'i njoftohet Siguruesit brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga data e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit apo nga data në të cilën ka qenë e mundur dhënia e njoftimit.

2. Trajtimi dhe pagesa e përfitimit.

a) Shoqëria e sigurimi, trajton kërkesën për dëmshpërblim dhe njofton të siguarin për pranimin e kërkesës dhe vlerën e dëmshpërblimit, apo refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e plotë e të nevojshëm.

b) Shoqëria e sigurimit paguan vlerën e dëmshpërblimit sipas kushteve të kësaj kontrate brenda 30 ditëve nga data e pranimin të vlerës së dëmshpërblimit nga i siguruari.

Neni 14
Juridiksioni

Çdo mosmarrëveshje mes palëve, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre, zgjidhet nga gjykata kompetente e Republikës së Shqipërisë.